



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
V E N D I M

Nr. 59, datë 01.06.2020

“PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E MIRATIMIT TË PAGESAVE TË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, PËR FAMILJET E EVAKUARA NGA BANESAT E TYRE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr. 8, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, miratuar me Ligjin nr. 96/2019, pikës 5, të Vendimit nr. 129, datë 03.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për pagesën e plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019”, Vendimit nr. 157, datë 27.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Në vendimet nr. 135, datë 05.12.2019, nr. 137, datë 06.12.2019, nr. 151, datë 16.12.2019 dhe nr. 162, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak, në të cilët janë miratuar pagesat e qirasë sipas vlerave të tregut të lirë për familjet e evakuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, bëhen ndryshimet në vlerat e qirasë për familjet e përcaktuara në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, si rezultat i ndryshimit të përbërjes së tyre familjare.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga bonusi i strehimit, në Programin e Strehimit Social, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2020.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar që të kryejë rakordimet përkatëse që lidhen me zbritjen/shtimin e vlerave të pagesave të qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I